



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI,
TË MBAJTUR MË 14.09. 2016 PËR PROJEKTLIGJIN NR.05/L-110 PËR
KAMATVONESAT NË TRANSAKSIONET TREGTARE**

SHTATOR
2016

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

KRYESUESI BLERIM GRAINCA: Nëse pajtoheni po fillojmë.

Mirë se keni ardhur,

Ju uroj mirëseardhje të gjithëve në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri.

Për ata që nuk më njohin që s'kemi pasur ratë të takohemi jam Blerim Grainca, deputet i LDK-së, njëkohësisht jam kryesues i grupit për Projektligjin për kamatëvonesat në transaksionet tregtare.

Kisha dashur që ky takim të ishte një format pak më madh, pak më i përmbajtur, por sido që të jetë ne i kemi ftuar gjithë akterët e mundshëm, gjith përfaqësuesit e komunitetit të biznesit, institucioneve që kanë të bëjnë me ligjin ose që atakohen nga fushëveprimi i këtij ligji.

Dhe shpresoj që me pjesëmarrjen e juaj sot pak do arrijmë që duke bashkëbiseduar të bëjmë këtë ligj më të mirë dhe më praktik për të gjithë akterët e mundshëm në një të ardhme ky ligj të hynë në funksion, të kenë benefit dhe të ndahen të kënaqur nga fushat të cilën e kemi rregulluar ne.

Siç e dini ky projektligj është i sponsorizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe ka ardhur në Kuvend.

Komisioni jonë e ka miratuar më datën 2 gusht, pastaj më datën 4 gushtë ka kaluar në Parlament në leximin e parëm, procedurën e ligjit kalon në dy lexime.

Dhe tani në mes të dy leximeve është diskutimi publik që bashkërisht të shprehim vërejtjet që keni ju edhe ne së bashku në mënyrë që para se të shkoj në Kuvend t'i harmonizojmë të gjitha qëndrimet që i kemi.

Fusha që rregullon ky ligj është një fushë mjaftë interesante, mjaftë e gjerë për arsye se rregullon marrëdhëniet në mes ta quaj operatorëve apo kompanive tregtare në mes veti dhe mes kompanive dhe njëkohësisht institucioneve publike të cilat po .. hyjnë në marrëdhënie kontraktuale për blerjen e mallrave apo shërbimeve në mes tyre.

Nëse pajtohem atëherë po e bëjmë një metodologji të punës. Fillimisht unë kisha thënë që fjalën t'ia japim përfaqësuesit të ministrisë, të japin një shpjegim për

projektligjin pasi që janë vetë sponzorizues të këtij ligji, pastaj të gjithë të tjerët do të kemi mundësi që t'i japim komentet, vërejtjet dhe sugjerimet tona. Urdhëro!

REXHEP BLLACA: Faleminderit, shumë!

Për ata që nuk më njohim unë jam Rexhep Bllaca drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të bankave,

Përfaqësues të shoqërisë civile, USAID-it,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si sponzorizues të këtij projektligji të paraqes qëllimin, arsyen dhe rëndësinë e Projektligji për kamatëvonesat në transaksionet tregtare.

Nëpërmjet këtij projektligji është që të krijohet baza ligjore për përcaktimin e rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatëvonesave në rastet e furnizimit me mallra dhe shërbime gjegjësisht kur palët kontaktuese janë bizneset ndërmjet veti në njërën anë si dhe palët kontraktuese transaksionet tregtare janë bizneset në njërën anën dhe institucionet shtetërore ose publike anën tjetër.

.. në mënyrë të sigurohet funksionimi i duhur i tregut duke nxitë aftësitë konkurruese të ndërmarrjeve dhe në nivel të tij të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

.. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është që të përshpejtoj dhe të procedoj pako legjislative në formën administrative që lehtëson dhe përmirëson ambientin e biznesit në vendin tonë.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë gjegjësisht Qeveria e Republikës së Kosovës këtë projektligj e ka ... Këshilli ... për vitin 2016, duke u bazuar edhe në planin kombëtarë për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit e aprovuar me vendim të Qeverisë me datën 16 dhjetor të vitit 2015 dhe këtë projektligj të sponzoron që sot është në përputhje me direktivën evropiane për luftimin e vonesave në transaksionet komerciale.

Ky ligj synon zvogëlimin e rasteve të kërkesave të vonuara në mënyrë që të vendosen praktikrat e drejta dhe bonafite me mirëbesim ndërmjet punëve në marrëdhëniet kontraktuese.

Ky ligj zbatohet për të gjitha llojet e kërkesave dhe ... që janë bërë si problem për transaksionet tregtare.

Në përgjithësi Ligji për kamatëvonesat kontribuon atë në procesin e mbledhjes së kredive siç e rregullon paketën e vonuar të kredive.

Ligji e përcakton edhe metodën e vendosjes së kamatëvonesës si dhe përcakton edhe metodën e llogaritjes së kamatëvonesës në institucionet kredituese.

Një gjë me rëndësi .. i këtij projektligji është që të vendos një kulturë me subjektet e marrëdhënieve kontraktuese që pagesat e detyrimit të bëhen me kohë dhe në mënyrë të shpejtë si dhe njëherit të ketë pasoja në transaksione për ata që vonohen me rastin e kryerjes së obligimeve kreditore në transaksionet tregtare.

Pra, .. është që projektligji që të vendosim ndaj .. ndërmjet bizneseve në njërën anë bizneset dhe institucionet publike në anën tjetër me rastin e vendosjes së ndonjë marrëdhënie kontraktuese.

Ky projektligji është hartuar me procedurat e parapara me Rregulloren e Punës së Qeverisë, ku janë konsultuar të gjithë akterët qoftë në fazën paraprake ashtu edhe fazën publike të konsultimit, një bashkëpunim shumë të gushtë kemi pasur ashtu me USAID-in dhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ne këtë projektligj e konsiderojmë si shumë të rëndësishëm për përmirësimin e ambientit të biznesit në vendin tonë.

Njëherit ky projektligj është në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian gjegjësisht qysh përmenda më herën direktivën e Bashkimit Evropian për luftimin e vonesave në transaksionet tregtare.

Po siç e përmendi edhe kryesuesi ne shpresojmë dhe jemi të bindur që përmbajtja e këtij ligji do të miratohet dhe do të pasohet dhe do të përmirësohet po ashtu gjatë amendamenteve në Kuvend ndërmjet dy leximeve dhe pastaj ju kisha lutë që të jepni sugjerimet, komentet pse jo vërejtjet e juaja lidhur me këtë projektligj.

Unë po e përfundoj këtu në mënyrë që të japim fjalën juve pasi që sugjerimet dhe komentet e juaja janë të mirëseardhur për neve për draft të këtij ligji. Faleminderit!

KRESUESI: Enver Hoti, është deputet nga subjekti politik Nisma, i urojmë mirëseardhje.

Zoti Bllaca faleminderit për informata, shpjegime për ato që i thatë. Unë hap debatin për këtë projektligj, shpresoj që secili nga ju të japë komentet e veta që janë të mirëseardhura.

Unë nuk ju përshëndeta nga një secilin, por ju përshëndeta të gjithë në grup, kështu që edhe një herë mirëseardhje për të gjithë. Urdhëro zoti Ilir!

ILIR GAXHA: Quhem Ilir Gaxha, kryesues i departamentit ligjor të bankave, njëkohësisht nënkryetar i Komisionit Ligjor në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

Këtu jam në cilësinë e Shoqatës së Bankave të Kosovës për shkak të shqetësimeve që i kemi pasur lidhur me memorandum më shumë se sa me ligjin.

Shoqata jonë nuk jep komente në ligj me qenë se si fushëveprim e ka përjashtua kamatëvonesën e cila aplikohet me nenin 2 për transaksionet mes personave fizik juridikë dhe institucionet financiar.

Megjithatë në memorandum kemi has një shpjegim se mbledhjen e kredive e rregullon dhe pagesat e vonuara të kredive, ... ka qenë qëllimi me cekë që është kreditimin e mallrave ose kreditimi në mjete kthimi që mendojmë ndoshta ja vlen me memorandum me qartësua.

Po ashtu, më tutje te neni 3, ligji synon të vendos për institucion financiar që të vazhdojnë me vendosjen e kamatëvonesës.

Thotë njëjtë sikur e drejtë me .. kamatë vonesën në institucione financiare mirëpo ki me vazhdua me rregullua, ndërsa në Projektligj i cili na është parashtrua dhe që e kemi para vetes sot kjo çështje nuk është trajtuar fare për shkak të përjashtimit me nënparagrafin 2.3, neni 2 te fushëveprimi.

Ndërsa sa i përket fushëveprimit si tërësi, ne mendojmë që këtë çështje e keni rregulluar me Ligjin për marrëdhënie të detyrimeve, do të thotë është përcaktuar lartësia.

Megjithatë Ministria ka mundur të nxjerr edhe një udhëzim administrativ vetëm që ta përcakton kushtet, afatet si llogaritët, kur llogaritët për me e qartësu me elaboru më tutje ligjin, mirëpo ka qenë zgjidhja e ministrisë me e shndërrua në ministri. E përshëndesim si iniciativë, mirëpo nga ... fushëveprimi e kemi të qartë që institucionet financiare të licencuara në Kosovë do të thotë do të rregullohen me një akt nënligjor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që

ne nga bankat kemi pritur që BQK-ja pas miratimit të ligjit të nxjerr një rregullore të veçantë, që ka të drejtën me nxjerrë rregullore, e cila t'i detyrojë ndoshta edhe bankat për aplikimin, mënyrat, kohëzgjatjet, afatet që do të rregullohen me këtë fushë.

Andaj, në emër të Shoqatës së bankave vetëm kishim kërkuar nëse mundet me u korrigjua memorandumimi, për të mos pasur dykuptimësi ose hamendje tek edhe deputetët tanë edhe publiku i gjerë me rastin e shkaktimit të një konfuziteti që ende jemi me kohë dhe mund ta korrigjojmë. Kështu që, prej zotit Bllaca kisha kërkuar, që ndoshta është vetëm gabim teknik dhe kemi mundësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Bllaca, keni ndonjë koment apo në fund doni... Urdhëroni, nëse dikush ka ndonjë vërejtje a sugjerim! Shfrytëzoheni lirinë e shprehjes dhe të komunikimit, sepse jemi këtu për të ngritur të gjitha shqetësimet që kanë të bëjnë me këtë.

Kjo e shqetësimeve dhe vërejtjeve që keni, ka të bëjë me juve, opozita s'kanë të drejtë me bë vërejtje, haha... Po, sepse ne jemi këtu për të ju dëgjuar juve, në mënyrë që në fund ligji të marrë formën e duhur dhe të plotësojmë standardet, për arsye se jemi të obliguar që të harmonizojmë edhe me legjislacionin evropian, por edhe me nevojat praktike, se shpeshherë po na ndodhë që të kemi ligje që janë të pazbatueshme në praktikë, ose po krijojmë dualizma dhe pastaj pasojat po janë të mëdha.

Më lejoni dy komente nga ajo që unë kam pa nga praktikatat e deritanishme, nga mungesa e këtij ligji na ka ndodhur që shpeshherë raportet në mes dy subjekteve apo dy operatorëve ekonomikë, që kanë raporte tregtare në mes vete, për shkak të mosefikasitetit në pagesa të rezultojnë ndoshta edhe me falimentimin e njerëzve në kompani, për shkak të vonësive të caktuara. Po ashtu, probleme që kam parë nga praktikatat është edhe marrëdhëniet kontraktuale, kur kanë me institucione publike.

Zakonisht, institucionet publike shpeshherë janë treguar të papërgjegjshme duke vonuar pagesat ndaj operatorëve ekonomik, ndaj kompanive në këtë rast, qoftë vendorë apo ndërkombëtarë, duke blerë mallra apo shërbime nga to dhe duke vonuar pagesat me muaj të tërë, shpeshherë deri edhe në vitin tjetër kalendarik, apo në vitin tjetër buxhetor.

Janë dy fusha, që ky ligj ka me i rregullua mirë, në mënyrë që ta evitojmë këtë problem ne jemi këtu për ta përkrahur biznesin, iniciativën private dhe komunitetin e biznesit.

Është folur goxha shumë lidhur me projektin ku shërbimet nga komuniteti i biznesit, nëse ka ndonjë koment?...

BESART SHATRI: Jam Besart Shatri, drejtor financiar në kompaninë e Ujë Rugove.

Fillimisht, dua të shpreh mirënjohjen ndaj ministrisë për iniciativën e tillë, në mënyrë që të rregullojë këto vonesat e pagesave në mes bizneseve, të cilat në përgjithësi nuk i rrinë gati pagesave ndërmjet bizneseve dhe që kjo normalisht krijon probleme në funksionimin e rregullt të kompanive.

Pyetja e vetme që ka qenë nga ana jonë është: institucioni kur i merr përsipër, domethënë, në mes të këtyre dy transaksioneve të bizneseve, e keni cekë që 8 % diku ka me qenë mesatarja e normës së ... BQK-së, që të shpallet në bazë gjashtëmujore, mirëpo a do të ketë një institucion i cili do të menaxhojë në vazhdimësi këto vonesa në mes bizneseve, qoftë bizneseve, qoftë institucioneve publike, normalisht shihet që ka vonesa të jashtëzakonshme.

REXHEP BLLACA: Faleminderit shumë!

Së pari t'i përgjigjem pyetjes së përfaqësuesit të bankës. Ka të drejtë për arsye se deri në momentin e fundit ka qenë pak diskutabile a do të përfshihen institucionet financiare, në fushëveprimin e këtij projektligji, me gjithat në fund arritëm në ... me Bankën Qendrore. E kemi pa të arsyeshme që pos ... banka qendrore është një institucion i specializuar dhe i thirrur për rregullimin e kësaj fushe.

Ne kemi krijuar bazë ligjore këtu, ndërsa kemi lënë që banka qendrore të ... rregullore, që ... pastaj ta përcaktojë metodën e detajizimit të ... sa i përket ... llogaritjes së kamatave të vonesave. Dhe, ndoshta ... shpjegues ... ideja ka qenë që vetëm të shpjegohet baza ligjore me këtë projektligj dhe ka vend për përmirësime dhe ne në bashkëpunim me ... ta evitojmë këtë lëshim.

Kurse, sa i përket pyetjes së kompanisë “Ujë Rugove” ligji vetëm vendos mënyrën e llogaritjes së kamatave dhe ka ... pastaj ndërmjet palëve duhet të zgjidhet ... me institucione gjyqësore, arbitrash ose mënyra tjera. Ndërsa, roli i Bankës Qendrore është vetëm ta menaxhojë rregullisht kamatën referente çdo gjashtë muaj, ndërsa nuk ka ndonjë institucion tjetër që do të menaxhojë konceptin e llogarive sa i

përket se a po zbatohet ky ligj a jo. mirëpo, megjithatë vendoset baza ligjore, që pastaj nesër kur t.... nuk ka pengesa për këtë

BESART SHATRI: Ne domethënë, në gjykata sot, jo që nuk jemi duke bërë një zgjidhje që është afatgjate dhe që është funksionale dhe nëse kemi vonesa të pagesave në mes bizneseve dhe ne duhet vazhdimisht në gjyqësore e procedura tutje, realisht jemi duke e shtyrë procesin në dy vjet e tutje. Mendoj se duhet të ... institucion i cili menaxhon e tjera. sllovenia, për shembull, si shtet ka mundësi një institucion i cili menaxhon këtë pjesën e që ti me pas mundësi

... ..

(Nuk dëgjohet për transkriptim.)

REXHEP BLLACA: Unë siç e përmenda më heret, edhe ky projektligj është i bazuar edhe në direktivën evropiane për luftimin e vonesave në transaksionet komerciale, mirëpo megjithatë, duke pasur parasysh që marrëdhëniet kontraktuale janë marrëdhënie janë marrëdhënie “interparty” ndërmjet palëve, unë jam shumë skeptik, që ndonjë institucion tjetër, përveç gjyqësorit, është në gjendje me e zgjidhë këtë kontest.

Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për ngarkesat në gjyqësor, megjithatë ndoshta trysnia më mirë është të bëhet te institucionet gjyqësore që së paku lëndëve të ... bizneseve t’u japin prioritet dhe nga ... të huaja, se sa të manovrojmë me institucione, të cilat nesër s’po di sa do të jenë të thirrura për t’i zgjidhur këto konteste. Mirëpo, megjithatë shqetësimi është shumë me vend, që vonesat vërtet n dikojnë në marrëdhëniet bizneseve, sidomos de palët e dobëta, se tek palët e forta ato mbijetojnë.

Dhe, qëllimi i këtij ligji, siç e thash edhe në ekspozë, është edhe që t’i mbrojë palët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, domethënë palët që janë më të dobëta në marrëdhëniet kontraktuale në treg.

Mirëpo, nëse ka ndonjë ide tjetër.... Ju e përmendët Slloveninë. Ne nuk kemi dijeni për këtë institucion në Slloveni, por nëse keni ndonjë material apo diçka tjetër, jeni të mirëseardhur për të na e dërguar, dhe s’ka problem.

KRYESUESI: Faleminderit zoti Bllaca! Funksionimi i gjykatave është një fushë tjetër që nuk e rregullon komisioni dhe për mua mundësia për të interferuar apo për të ndikuar është shumë e vogël dhe gjithsesi, nëse këta do të kishin futur ndonjë nen të veçantë, atëherë kishte me qenë një ndërhyrje në sistemin gjyqësor dhe në

ligjet tjera, kurse ju e dini që në Kosovës, besoj tash e dy vjet ka filluar të operojë edhe institucioni i përmbauesve privatë, të cilët janë një mekanizëm për arkëtimin ose të pagesave që mund të jetë një shkallë e parë të themi para se t'i adresohen gjykatës, nëse nuk ka mundësi tjetër.

Gjithësesi edhe mekanizmat tjerë të cilët nuk janë në kundërshtim me ligjin, sponzoruesi duhet me i pa si mundësi, por pa pasur ndërhyrje në gjithë sistemin juridik të vendit sepse janë gjykatat ato të cilat marrin vendimin përfundimtar.

Kush e do fjalën tjetër? Urdhëroni zotëri Gaxha!

ILIR GAXHA: Faleminderit zoti kryesues!

Ndoshta kishte me qenë sikur zgjidhje, që e përmendi edhe kryesuesi, në momentin kur ky ligj në fuqi, nëse dërgohet fatura për përmbaues faturës përmbauesi automatikisht ka të drejtë t'ia shtojë edhe vlerën e përqindjes se si llogaritet dhe nënkupton që përmbauesi i dhunshëm i mjeteve nga llogaria e debitorit, në momentin kur s'i janë paguar detyrimet, do të përfshijë edhe atë shumë të interesit.

Mirëpo, në anën tjetër, çka mundeni ju të bëni është përmes odës ku jeni anëtarë, qoftë Oda Ekonomike e Kosovës apo Oda Amerikane Kosovare dhe përmes Odës të kërkohet që së paku anëtarët të cilët janë pjesë e odës, të respektojnë, me bë një lloj marrëveshjeje për këtë ligj dhe kamatën që vullnetarisht të paguhet. Mirëpo, tash po flasim për një debitor i cili ndoshta është i pandërgjegjshëm dhe qëllimi është të mos paguajë dhe ai s'po e paguan as borxhin kryesor e lëre më interesin, kështu që fushëveprimi i këtij ligji nuk mund ta rregullojë atë çështje.

Meqenëse institucionet gjyqësore, mendoj se janë me përgjegjësi të mbingarkuara, me numër të rasteve dhe ka vonesa çdo ditë, debitorët e pandërgjegjshëm përfitojnë, mirëpo kjo e rregullon pak fushën që ndoshta disa prej tyre nuk kanë llogari ta vonojnë për shkak se do të përfundojnë duke e paguar edhe kamatë-vonesën.

Përpara gjykata i ka llogaritur sikur kamata ligjore dhe i ka marrë sikur bazë shumë e depozitave apo interesin e depozitave që është paguar nëpër banka, 3.5% - 4% kështu lloj shumë, që kanë qenë dukshëm më të vogla. Se nëse ti si kreditor, e ke kredituar mallin, ti paguan nëpër banka interes shumë më të lartë dhe nuk paguhet apo shpërblehet nëse kompensohesh vetëm pjesërisht për atë kamatë-vonesë sa e ke pritur për mall.

Mirëpo, dy institucionet tjera që mundeni për t'i shfrytëzuar është ndërmjetësimi dhe arbitrazhi. Nëse me palët, me të cilat keni marrëdhënie kontraktuale mundeni të parashikoni me kontratë edhe zgjidhjen e konteksteve përmes ndërmjetësimit, është një mënyrë më efikase, më e shpejtë dhe me kosto shumë të ulët për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet, mirëpo prapë ngelen vullnetarisht palët për ta përmbushur atë marrëveshje në të cilën janë.

Në anën tjetër, arbitrazhi e zëvendëson rolin e gjykatave. Nëse keni marrëveshje ekskluzive që juridiksioni ia jep një zgjidhje të konteksteve apo të mosmarrëveshjeve të mundshme arbitrazhit, atëherë arbitri do të duhej të marrë vendim përfundimtar dhe çka është përparësia në krahasim me gjykatat është se nuk kanë të drejtë palët të ankohen, sepse në gjykata përfundon shkalla e parë dhe vazhdon me shkallën e dytë, e shkallën e tretë dhe është procesi i ankesave i stërzgatur i cili edhe shkakton dëm.

Mirëpo, te rasti i arbitrazhës, nëse është vendimi përfundimtar, atëherë ajo është e përmbarueshme dhe direkt mund të shkosh në përmbarim.

Por, meqë veç ekziston shërbimi kontraktues ku ju i kreditoni me mall dhe e lëshoni një faturë, fatura është dokument i besueshëm dhe si të tillë, ju kisha rekomanduar të bëhet një origjinal më shumë për ta nënshkruar për shkak se në dokument origjinal kërkohet përmbarimi dhe kjo është rruga më e shpejtë dhe e mundshme në kuadër të ligjit tonë që lejohet.

BESART SHATRI: Do të thotë, ne nuk po flasim për një raport kontraktual në mes të biznesi apo për një biznes të caktuar, sepse ti, në momentin që po e qet në përmbarim, sot në Kosovë qysh po funksionon, ti e ndërpre në qarkullimin totalisht. Do të thotë, ty nuk të konvenon si biznes, apo ai tjetri, që do të thotë llogaritet në kuadër të bizneseve prodhuese, ti nuk e ke fuqinë me ia determinua pikave tregtare të mëdha, afatin e pagesës, edhe pse nuk e përmbushë.

Do të thotë, në momentin që ti shkon në përmbarim, ti e ke ndërprerë qarkullimin me to, që ideja e projektligjit është për ta mbrojtur konkret tregun. Do me thënë, funksionimin e tregut, jo palët një për një. Prandaj, kjo edhe po krijon problem në vazhdimësi, është problemi i kompanisë tonë, mirëpo ka edhe probleme tjera se në vazhdimësi janë kompanitë prodhuese në këtë mënyrë që funksionojnë.

Do të thotë, nënshkruhen kontrata për 45 ditë, për 90 ditë mirëpo pagesa, vonesa shkon deri në 120 ditë apo 180 ditë dhe ajo ndikon keq, që do të thotë se nuk ke mundësi të financosh vazhdimisht mall për një blerës të caktuar.

Në këtë aspekt e propozova një institucion i cili menaxhon, dhe tash nuk po di cili institucion kishte mund të caktohet, por që kishte mund ta rregullojë funksionimin e tregut.

Përndryshe, kjo për në gjykata, ideja është shumë e mirë, mirëpo sa është e realizueshme, nuk e di. Nuk është në praktikë e realizueshme, sepse do të ketë vonesa në vazhdimësi.

Në këtë aspekt e orientova unë diskutimin.

KRYESUESI: Pra, të gjitha vërejtjet e sugjerimet janë të mirëseardhura dhe ato do të incizohen gjatë tërë diskutimit, dhe më vonë do të bëhet transkripti, i cili do të jetë pjesë e vendimeve finale të Komisionit para se ky ligj të shkojë në Parlament për miratim përfundimtar.

Unë e kam edhe një pyetje për juve që vini kryesisht nga komuniteti i biznesit dhe që lidhet me këto afate, që janë kryesisht 30-ditëshe dhe në parim unë mendoj që janë OK, por nëse mendoni se duhet ndryshuar, atëherë ndoshta mendoni të jetë më shpejt dhe pas pranimit të faturës, apo më vonë. Pra, nëse keni vërejtje lidhur me këtë pikë.....

ILIR GAXHA: Po e marr ndoshta shpesh fjalën, por ndoshta është mirë gjithmonë të parashikohet që nëse s'është e rregulluar në mes palëve ndryshe, atëherë duhet të jetë 30 ditë.

Përndryshe, nëse palët kanë interes brenda 7 ditëve ta paguajnë, nuk ka nevojë të pritët 30 ditë, ose nëse qarkullon malli aq shpesh që e furnizon çdo 07 ditë, për shembull, atëherë nuk ka nevojë të pritët 30 ditë.

Mirëpo, në rast se nuk është paraparë, atëherë të jetë 30-ditëshi i detyruar për palët, kjo është më e arsyeshme.

Por, nëse kreditori me mall ose me shërbime, vendos vetë me i dhënë 60 ditë, është zgjidhje e tyre dhe nuk duhet të ndërhyjë ligji dhe të pengojë marrëdhënien kontraktuale.

KRYESUESI: Faleminderit! A ka kush edhe ndonjë koment? Atëherë, meqë shumica e vërejtjeve dhe komenteve u dha nga ana juaj, unë si kryesues i këtij grupi punues, i mirëpres të gjitha vërejtjet e komentet tuaja dhe ato t'i dërgoni edhe

me shkrim, nëse keni në ndërkohë ndonjë sugjerim apo rekomandim dhe stafi ynë do t'i konsultojë të gjitha vërejtjet tuaja dhe do t'i paraqiten Komisionit për shqyrtim dhe besoj që bashkërisht do të arrijmë të nxjerrim një prej versioneve më të mira të këtij draft-ligji në mënyrë që ta rregullojmë përfundimisht këtë fushë.

Unë i kisha rekomanduar edhe një herë MTI-së që të ketë sa më pak mundësi, apo, siç është bërë praktikë në institucionet tona që shumë gjëra të rregullohen me akte nënligjore ose udhëzime administrative.

Udhëzimet administrative dhe aktet nënligjore pastaj po lejojnë mundësi të manipulimeve të ndryshme, gjegjësisht harmonizimit të interesave përmes udhëzimeve administrative, varësisht se kush vjen apo kush shkon nga pushteti apo cilat interesa preken.

Prandaj, unë ju rekomandoj që ta shikoni edhe një herë këtë mundësi që sa më pak të ketë pjesë të cilat rregullohen me akte nënligjore gjegjësisht udhëzime administrative sepse jemi të interesuar që t'i rregullojmë me ligj, në mënyrë që kjo fushë të jetë sa më e sigurt për operim.

Unë, edhe një herë ju falënderoj për kohën që keni gjetur. Jeni të mirëseardhur me të gjitha vërejtjet e komentet që i keni ndërkohë. Uroj të gjitha të mirat!